URDHËR
Nr. 43, datë 7.2.2020

DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të neneve 12, pika 1 dhe 13, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 7, pika 3, të rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë znj. Rezarta Schuetz, si vijon:

a) përfaqëson Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në marrëdhënie me të tretët;

b) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Kolegjit;

c) nënshkruan aktet e tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me përjashtim të vendimeve.

2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është për periudhën nga data 12 shkurt 2020 deri në datën 15 shkurt 2020.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, znj. Rezarta Schuetz.

4. Znj. Rezarta Schuetz nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Natasha Mulaj